



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 67

Tiranë – E enjte, 30 prill 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 22.4.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 11, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2015 në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar..... 2965
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 22.4.2015	Për dhënie grade “Drejtues madhor”..... 2965
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 331, datë 22.4.2015	Për mbrojtjen e veçantë të punonjësit të policisë që, për shkak të detyrës, i kërcënohet jeta, familja dhe prona..... 2965
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 22.4.2015	Për kalimin, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, të pasurisë së paluajtshme, të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8525, me numër pasurie 26/71, Elbasan, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Prokurorinë e Rrethit Elbasan..... 2966
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 335, datë 22.4.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 279, datë 12.4.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së objekteve të operacioneve hidrokarbure, pjesë e marrëveshjes së lidhur më 26.7.1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetikës (sot Ministria e Energjisë dhe Industrisë) dhe Albpetrol-it, Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe Gazit (sot shoqëria “Albpetrol”, sh.a.)”..... 2968
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 337, datë 22.4.2015	Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve..... 2970
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 22.4.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 253, datë 6.3.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore”..... 2980
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 339, datë 22.4.2015	Për përcaktimin e elementeve përbërëse, mënyrës së vendosjes dhe afatit të lëshimit të pullës së kontrollit të barit..... 2980

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 340, datë 22.4.2015	Për bashkëfinancimin e projektit “Rikonstruksioni i muzeut “Marubi””.....	2981
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 341, datë 22.4.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga rikonstruksioni i bulevardit “Osumi”, faza e parë, në bashkinë e Beratit.....	2982
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 342, datë 22.4.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga rikonstruksioni i rrugës “Unaza e jashtme e qytetit”, si dhe sistemimi i rrugës te lagja “Cfake” pranë Kasapit, në bashkinë e Gjirokastrës.....	2983
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 343, datë 22.4.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës së transmetimit 110 kv, Uznovë – Çorovodë.....	2984
Udhëzim i ministrit të Financave, ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 15, datë 8.4.2015	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 2.2.2015, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 8, datë 14.1.2015 të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike”.....	2986
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 41, datë 7.4.2015	Për fillimin e procedurave për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr. 87, datë 26.9.2011, tek shoqëritë “Alb-Energy” sh.p.k, “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k.....	2986
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 42, datë 7.4.2015	Për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës me nr. 138, seria pv11k për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et e “Pellgut të Okshtunit”, me fuqi 31,489 MW, të shoqërisë “Diteko” sh.p.k. të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 114, datë 16.11.2011.....	2988
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 43, datë 7.4.2015	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.....	2988
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 44, datë 7.4.2015	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Kisi-Bio-energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kacni”.....	2989
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 45, datë 7.4.2015	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike....	2990
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 46, datë 7.4.2015	Për rishikimin e Planit të Investimeve të OST sh.a. për vitin 2015.....	2991

**VENDIM**

Nr. 329, datë 22.4.2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 11, DATË 14.1.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PUNONJËSIT ME KONTRATË TË
PËRKOHSHE PËR VITIN 2015 NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 11, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet “... 1218 veta ...”.

2. Në lidhjen nr. 1 bashkëlidhur vendimit bëhen këto shtesa:

a) Pas ndarjes “22. Ministria e Kulturës” shtohet ndarja “23. Ministria e Mjedisit”, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Në ndarjet “5. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës”, “8. Ministria e Arsimit dhe Sportit” dhe “11. Ministria e Punëve të Brendshme” shtohen nënndarjet, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

Tabela e nënndarjeve

Emri i Institucionit	Nr. Punonjës	Emërtesa	Koha ditore	Periudhë kohore
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	4			
Aparati	4	Specialist arkivist	5 orë/ditë	vjetore
Ministria e Arsimit dhe Sportit	17			
Aparati	17	Specialist	8 orë/ditë	4 mujore
Ministria e Punëve të Brendshme	3			
Aparati Drejtorise së Përgjithshme të Policisë	3	teknik	8 orë/ditë	4 mujore
(23)Ministria e Mjedisit	130			
Drejtorite e Shërbimit Pyjor	130	vrojues	8 orë/ditë	4 mujore

VENDIM

Nr. 330, datë 22.4.2015

**PËR DHËNIE GRADE “DREJTUES
MADHOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 53, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Haki Çako, Drejtor i Policisë së Shtetit, i jepet grada “Drejtues madhor”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 331, datë 22.4.2015

**PËR MBROJTJEN E VEÇANTË TË
PUNONJËSIT TË POLICISË QË, PËR
SHKAK TË DETYRËS, I KËRCËNOHET
JETA, FAMILJA DHE PRONA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 72, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Policia e Shtetit siguron mbrojtje të veçantë për punonjës të policisë, që, për shkak të detyrës, i kërcënohet jeta, familja dhe prona.

2. Me mbrojtje të veçantë do të kuptohen masat me karakter organizativ dhe profesional për ruajtjen fizike të punonjës të policisë.

3. Masat e mbrojtjes së veçantë janë:

a) ruajtje fizike;

b) ruajtje e familjarëve, banesës dhe pronës.

4. Me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit ngrihet Komisioni i Vlerësimit të Kërcënimeve (KVK) për vlerësimin e kërkesave, miratimin e masave të mbrojtjes, ndryshimin, revokimin ose përfundimin e tyre, si dhe struktura përgjegjëse për zbatimin e masave të mbrojtjes së veçantë, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.



5. Shpenzimet për realizimin e mbrojtjes së veçantë përballohen nga buxheti i miratuar për Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

6. Vendimi nr. 38, datë 26.1.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për një mbrojtje të veçantë të personave, që ndihmojnë policinë dhe të punonjësve të policisë, që u kërcënohet jeta, familja, prona, për shkak të detyrës”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 334, datë 22.4.2015

**PËR KALIMIN, NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
DREJTËSISË, TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, TË NDODHUR NË
ZONËN KADASTRALE NR. 8525, ME
NUMËR PASURIE 26/71, ELBASAN, PËR
GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR
ELBASAN DHE PROKURORINË E
RRETHIT ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 14, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, të pasurisë së paluajtshme, të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8525, me numër pasurie 26/71, me adresë: Lagjja “5 Maji”, Elbasan, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Prokurorinë e Rrethit Elbasan, sipas kartelës dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Pasuria e mësipërme të përdoret në funksion të ndërtimit të godinës së re të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Prokurorisë së Rrethit Elbasan, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së këtyre institucioneve.

3. Ministria e Drejtësisë nuk mund ta ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, dhe as ta tjetërsojë atë.

4. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Prokuroria e Rrethit Elbasan dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



ZRPP **HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT** (Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
ELBASAN

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
ZONA KADASTRALE 8525 NR PASURISE 26/71 VOL. _____ FQ. _____
INDEKSI I HARTES EL. K. 10 SHKALLA 1:500
ADRESA E PASURISE RRËTHI ELBASAN Q/T ELBASAN
RR/L 5 MAJ P/G _____ SH _____ K _____ Ap _____

B. KUFIZIMET
V. 26/27, 19/41
L. 19/41
J. 19/41, 26/64
P. 26/64, 26/76, 26/67
D. DATA 15/09/2014 ORA 10:00

C. PRONARI
SHTET

MAP

26/67
26/79
26/75
26/64
26/55
26/71
N. 12/211
19/41
26/1
26/1/1

SUPERFAQJA E TRUALETT=1571M2
NGA KY NDERTESE=404M2



ELBASAN		ZONA KADASTRALE NR. 8525				BLLOKU NR. 26			
Indeksi artef. EL	Lloji i pasurisë	Sip. truall (m ²)	Nga Sip. truall sa ndërtese	Pronari (Emri Atesia Mbiemri)	Adresa e Pronës	Dokumenta të pronësise pas 1991	para 1991	Vend. Gjyk.	Pershkrim i veçantë
9	Truall	245,73	108,82	Kleanthi Kole Boshi	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
9	Truall	245,94	93,11	Dhimiter Kole Boshi	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
9	Truall	214,05	68,85	Agron Stefan Bushaku	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
10	Truall	136,63	108,47	Kasem Rrapush Dyma	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
9	Truall	273,83	107,67	Jani Kole Dhamo	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
9	Truall	801,12	267,62	Marja Lepku	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
9	Truall	163,05	163,05	Bashkepronesi	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Pallat 2kt 68/1
9	Truall	55,04		Dashamir Nikollaq Bibaja	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Truall (are)
9	Truall	175,67		Irfan Disha	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Truall (are)
9	Truall	151,71		Sherif Vodha	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Truall (are)
9	Truall	80,51	35,06	Bashkim Rudi	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
10	Truall	508,48		Shteti	Lagja "5 Maj"				Rruge
9	Truall	796,07	135,83	Vilson Todi Bull	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
9	Truall	157,11	131,66	Zeqine Avdi Elmazi	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
10	Truall	2703,66	1174,00	Familja "Nosi"	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Kthyer nga Komisioni i
10	Truall	38,92	38,92	Petrit Sina	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
10	Truall	37,74	37,74	Dalip Jangulli	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Dyqan
10	Truall	288,05	76,05	Besnik Shaban Avdia	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Dyqan
10	Truall	1571,39	458,98	Shteti	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Hetuesia e Rrethit
10	Truall	1491,95	191,14	Muharrem Lolja	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Ish sektori i Bojaxhive
10	Truall	328,00	176,71	Stefan Petro Bul	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
9	Truall	464,63	124,13	Frederik Stefan Bull	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
10	Truall	23,45		Dashamir Nikollaq Bibaja	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Garazhd
10	Truall	28,84	28,84	Irfan Bari Disha	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
9	Truall	358,17	229,66	Vangel Zoi Mitri	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
10	Truall	451,52	314,06	Familja "Nosi"	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Kthyer nga Komisioni i
9	Truall	208,62	96,73	Spiro Liazar Karafili	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
9	Truall	111,77	93,64	Murat Sulejman Drazhdi	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
	Truall	146,78	81,21	Kostandin Thanas Bull	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament
	Truall	132,90	103,11	Rrzhdi Veli Matrazhiu	Lagja "5 Maj"	Po	Po	Po	Apartament

VENDIM

Nr. 335, datë 22.4.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 279, DATË 12.4.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË OBJEKTEVE TË OPERACIONEVE HIDROKARBURE, PJESË E MARRËVESHJES SË LIDHUR MË 26.7.1993, NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRIJË, BURIMEVE MINERARE DHE ENERGJETIKËS (SOT MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIJË) DHE ALBPETROL-IT, BASHKËSISË EKONOMIKE TË NAFTËS DHE GAZIT (SOT SHOQËRIA "ALBPETROL", SH.A.)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 13, të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993, "Për hidrokarburet (Kërkimi dhe prodhimi)", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 279, datë 12.4.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Kudo në vendim, emërtimi "Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës" zëvendësohet me "Ministria e Energjisë dhe Industrisë".

b) Në listat "B" dhe "C" të objekteve të operacioneve hidrokarbure, pjesë e marrëveshjes së lidhur më 26.7.1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetikës (sot Ministria e Energjisë dhe Industrisë) dhe Albpetrol-it, Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe Gazit (sot shoqëria "Albpetrol", sh.a.), miratuar me vendimin nr. 279, datë 12.4.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet sipas listave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



**NDRYSHIMI I LISTËS SË OBJEKTEVE TË
KRYERJES SË OPERACIONEVE
HIDROKARBURE, BASHKËLIDHUR
MARRËVESHJES SË LIDHUR MË DATË
26.7.1993, MIDIS MINISTRISË SË
INDUSTRIËS, BURIMEVE MINERARE
DHE ENERGJETIKËS (SOT MINISTRIA E
ENERGJISË DHE INDUSTRIËS) DHE
ALBPETROL-IT, BASHKËSISË
EKONOMIKE TË NAFTËS DHE GAZIT
(SOT SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA)**

1. Në listën “B” të marrëveshjes, hiqen këto objekte kërkimi:

Blloku i Panajasë

1. Ndërprerja e gjerësisë gjeografike veriore 40° 36' 17" V me vijën bregore të detit Jon të përcaktuar me nivelin mesatar të baticës:

2. 40° 36' 17" V 19° 37' 00" L;
3. 40° 27' 00" V 19° 37' 00" L;
4. 40° 27' 00" V 19° 29' 10" L; ose

Ndërprerja e gjerësisë gjeografike veriore 40° 27' 00" V me vijën bregore të përcaktuar me nivelin mesatar të baticës.

Blloku i Dumresë

1. 41° 00' 00.0" V 19° 45' 00.0" L;
2. 41° 00' 00.0" V 19° 48' 00.0" L;
3. 41° 05' 00.0" V 19° 48' 00.0" L;
4. 41° 05' 00.0" V 20° 02' 00.0" L;
5. 40° 50' 00.0" V 20° 02' 00.0" L;
6. 40° 50' 00.0" V 19° 45' 00.0" L.

2. Në listën “C” të marrëveshjes hiqen këto objekte kërkimi.

Blloku 1

- 41° 30' 00" V 20° 00' 00" L;
- 41° 30' 00" V 20° 28' 10" L;
- 41° 05' 23.8" V 20° 37' 59.1" L;
- 41° 00' 00" V 20° 38' 20" L;
- 41° 00' 00" V 20° 02' 00" L;
- 41° 05' 00" V 20° 02' 00" L;
- 41° 05' 00" V 20° 00' 00" L.

Blloku 4

- 40° 09' 10.0" V 20° 41' 25.0" L;
- 40° 20' 00.0" V 20° 30' 00.0" L;
- 40° 30' 00.0" V 20° 30' 00.0" L;
- 40° 30' 00.0" V 20° 15' 00.0" L;
- 40° 20' 00.0" V 20° 15' 00.0" L;
- 40° 20' 00.0" V 20° 00' 00.0" L;
- 40° 05' 00.0" V 20° 00' 00.0" L;
- 39° 55' 00.0" V 20° 15' 00.0" L;

39° 55' 00.0" V 20° 20' 50.0" L.

Pika 1. Është ndërprerja e linjës 1-2 me linjën e kufirit ndërkombëtar midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Pika 9. Është ndërprerja e paralelit 39° 55' V me linjën e kufirit ndërkombëtar midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Blloku 5

- 40° 27' 00.0" V 19° 29' 10.0" L;
- 40° 27' 00.0" V 19° 37' 00.0" L;
- 40° 14' 00.0" V 19° 37' 00.0" L;
- 40° 14' 00.0" V 19° 58' 00.0" L;
- 40° 20' 00.0" V 19° 45' 00.0" L;
- 40° 20' 00.0" V 20° 00' 00.0" L;
- 39° 57' 30.0" V 20° 00' 00.0" L;
- 39° 52' 00.0" V 20° 09' 40.0" L;
- 39° 55' 00.0" V 20° 15' 00.0" L;
- 39° 55' 00.0" V 20° 20' 50.0" L;
- 39° 38' 49.8" V 20° 00' 31.5" L.

- Pika 1. Është ndërprerja e paralelit 40° 27' V me vijën bregdetare të detit Adriatik në gjirin e Vlorës.

Pika 10. Është ndërprerja e paralelit 39° 55' V me linjën e kufirit ndërkombëtar midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Pika 11. Është ndërprerja me vijën bregdetare të detit Jon me vijën ndërkombëtare të kufirit midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Blloku 6

- 41° 00' 00" V 20° 15' 00" L;
- 41° 00' 00" V 20° 38' 20" L;
- 40° 09' 10" V 20° 41' 25" L;
- 40° 20' 00" V 20° 30' 00" L;
- 40° 30' 00" V 20° 30' 00" L;
- 40° 30' 00" V 20° 15' 00" L.

Blloku 7

- 42° 00' 00" V 19° 45' 00" L;
- 42° 00' 00" V 20° 36' 30" L;
- 41° 30' 00" V 20° 28' 10" L;
- 41° 30' 00" V 20° 00' 00" L;
- 41° 40' 00" V 20° 00' 00" L;
- 41° 30' 00" V 20° 28' 30" L.

Blloku 8

Ndërprerja e gjerësisë gjeografike 42° 05' 00" V me kufirin e njohur ndërkombëtarisht midis Shqipërisë dhe Malit të Zi:

- 42° 05' 00" V 19° 45' 00" L;
- 42° 00' 00" V 19° 45' 00" L;
- 42° 00' 00" V 20° 36' 30" L.

Blloku C



Ndërprerja e gjerësisë 41° 20' 00" V me vijën bregore në nivelin mesatar të baticës:

41° 20' 00" V 19° 45' 00" L;

41° 00' 00" V 19° 45' 00" L.

Ndërprerja e gjerësisë 41° 00' 00" V me vijën bregore në nivelin mesatar të baticës (kufiri jugor).

VENDIM

Nr. 337, datë 22.4.2015

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KRYERJES SË PROCESIT TË KALIMIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE NË PRONËSI TË PËRFITUESVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi:

a) afishon, në vendet publike të njësisë së qeverisjes vendore, dhe boton, në gazetën e pushtetit vendor, apo në njëerën nga gazetatat e përditshme vendore ose kombëtare, lajmërimin publik të paraqitjes së dokumentacionit, sipas pikave 2 e 3, të këtij vendimi, për të gjithë përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi (AMTP), sipas përcaktimeve të nenit 2, të ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve";

b) i kërkon zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) kopje të hartave kadastrale, për zonat kadastrale (fshat apo qytet) që kanë qenë territor i ish-ndërmarrjes bujqësore, nën juridiksionin territorial të asaj njësie ku familjet bujqësore apo individët janë subjekte përfituese të tokës bujqësore, sipas nenit 2, të ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, në pronësi të

Faqe | 2970

përfituesve", dhe e përdorin tokën për veprimtari bujqësore, por kanë mungesa në plotësimin e dokumentacionit të përdorimit apo pronësisë. ZVRPP-ja ia dërgon hartat kadastrale komunës/bashkisë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve.

Në rast se ZVRPP-ja nuk i disponon hartat kadastrale, për të cilën shprehet zyrtarisht, brenda afatit të përcaktuar, atëherë kryetari i njësisë së qeverisjes vendore kërkon nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), pranë këshillit të qarkut, hartat kadastrale përkatëse, në bazë të të cilave është realizuar ndarja e tokës bujqësore. DAMT-i ia dërgon hartat kadastrale njësisë së qeverisjes vendore brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve.

2. Përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me AMTP, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, paraqesin, në njësinë e qeverisjes vendore,;

a) kërkesën për pajisjen me AMTP për tokën që e kanë marrë në përdorim nga komisionet e ndarjes së tokës;

b) planvendosjen e secilës ngastër që kanë në përdorim, të përgatitur nga një subjekt i licencuar, sipas kërkesave të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku të pasqyrohen sipërfaqja, kufijtë e saj dhe kufitarët;

c) certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile e njësisë së qeverisjes vendore, ku të pasqyrohet numri i anëtarëve të familjes përfituese ose individit, në favor të së cilit do të lëshohet akti i marrjes së tokës në pronësi, sipas gjendjes më 1 gusht 1991, me ndryshimet deri më 1 tetor 1992, të cilë nuk kanë ndryshuar vendbanimin e tyre që prej kësaj date;

ç) dokumentacionin që vërteton se janë përfitues, si rezultat i lëvizjes nga qendrat e tyre të banimit, me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave;

d) aktin e marrjes së tokës bujqësore në përdorim, nëse e disponojnë.

3. Subjektet e përcaktuara si bashkëthemeluese të ish-ndërmarrjes bujqësore, sipas vendimit nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, "Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore", të ndryshuar, të cilat nuk janë pajisur me AMTP, për tokën bujqësore që kanë në përdorim faktik, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve



nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të paraqesin në njësinë e qeverisjes vendore:

a) kërkesën për pajisjen me AMTP, për tokën që kanë marrë në përdorim nga komisionet e ndarjes së tokës;

b) dokumentacionin kadastral, hipotekor, arkivor apo gjyqësor që provon pronësinë mbi tokën bujqësore apo rrënjët e ullinjve para reformës agrare dhe qenien e tyre si themelues të ish-kooperativës apo ish-ndërmarrjes bujqësore;

c) planvendosjen e ngastrës/ave që subjekti përdor për qëllime bujqësore, të përgatitur nga një subjekt i licencuar, sipas kërkesave të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku të pasqyrohen sipërfaqja, kufijtë e saj dhe kufitarët;

ç) certifikatën e trungut familjar (përbërjen e familjes) në momentin e dorëzimit të tokës bujqësore dhe çdo dokument tjetër, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar;

d) aktin e marrjes së tokës bujqësore në përdorim, nëse e disponojnë.

4. Administrata e njësisë së qeverisjes vendore regjistron, në një regjistër të veçantë, të gjitha kërkesat e paraqitura nga përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me AMTP.

5. Njësia e qeverisjes vendore, në bazë të dokumentacionit që disponon,:

a) kontrollon nëse për ngastrat e tokës bujqësore, për të cilat është paraqitur kërkesë, sipas pikës 2 apo 3, të këtij vendimi, është lëshuar më parë AMTP për përfitues të tjerë, individë apo familje bujqësore. Në rastet kur vërtetohet ky fakt, sipas përcaktimit të nënndarjes “iii”, të shkronjës “b”, të nenit 2, të ligjit nr. 57/2012, njësia e qeverisjes vendore njofton, me shkresë, kërkuuesin, duke i refuzuar kërkesën;

b) verifikon qenien përfitues i tokës bujqësore në pronësi, sipas përcaktimeve të nenit 2, të ligjit nr. 171/2014. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore u kthen përgjigje për refuzim të kërkesës kërkuësve, të cilët nuk plotësojnë këtë kusht;

c) refuzon pranimin e kërkesës, në çdo rast, kur është vënë në dijeni zyrtarisht, nga gjykata, se për ngastrat e tokës bujqësore, të paraqitura në kërkesë, ka një konflikt gjyqësor.

6. Njësia e qeverisjes vendore, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij

vendimi, evidenton në hartat kadastrale ngastrat e tokës në përdorim faktik, sipas kërkesave të paraqitura, vetëm për përdoruesit që plotësojnë kushtin e subjektit përfitues, sipas nenit 2, të ligjit nr. 171/2014.

Harta kadastrale përmbledhëse përgatit dy kopje origjinale, nga të cilat njëra kopje mbetet në arkivin e komunës/bashkisë dhe tjetra i përcillet, zyrtarisht, kryesisë së secilit fshat që ndodhet në juridiksionin territorial të komunës/bashkisë.

7. Njësia e qeverisjes vendore afishon për konsultim publik, për 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, në vendet publike të fshatit dhe të njësisë së qeverisjes vendore, listën e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore, vendndodhjen e saj, sipërfaqen dhe kufitarët për çdo ngastër.

Gjatë periudhës së afishimit, çdo pretendues si përdorues, që nuk e gjen emrin në listë, paraqet ankesë me shkrim pranë kryetarit të komunës/bashkisë, i cili, pas shqyrtimit, bën korrigjimet përkatëse.

8. Kryesia e secilit fshat të njësisë së qeverisjes vendore, pas afishimit të listës së përdoruesve, verifikon, në prani të përfaqësuesve madhorë të çdo familjeje bujqësore, dhe bën saktësimet e nevojshme, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur sipas pikave 2 e 3, të këtij vendimi. Në përfundim të afatit 15-ditor, kryesia e fshatit, në një mbledhje me të gjithë përdoruesit faktikë të tokës bujqësore, komunikon rezultatet e verifikimeve të kryera, duke evidentuar edhe vërejtjet e pretendimet e paraqitura.

9. Kryesia e secilit fshat, pas kryerjes së procedurave, të përcaktuara në pikën 8, të këtij vendimi, ia rikthen, brenda 2 (dy) ditësh, njësisë së qeverisjes vendore hartën kadastrale dhe listën përmbledhëse, duke e shoqëruar me të gjitha vërejtjet, mendimet e sugjerimet që kryesia e fshatit ka për secilin nga përdoruesit faktikë të tokës bujqësore si dhe me vërejtjet që janë paraqitur gjatë periudhës së afishimit publik. Dokumentacioni i kthehet administratës së njësisë së qeverisjes vendore me shkrim, i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e kryesisë së fshatit, pjesëmarrës në mbledhje, dhe i vulosur me vulën e kryeplakut. Çdo nënshkrues shkruan me dorën e vet emrin, atësinë dhe mbiemrin.

10. Njësia e qeverisjes vendore, duke u konsultuar me të gjitha vërejtjet, kërkesat,



mendimet e sugjerimet që ka paraqitur kryesia e fshatit apo individët e interesuar, për secilin nga përdoruesit faktikë të tokës bujqësore, brenda 100 (njëqind) ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, përgatit relacionin përfundimtar për përdoruesit e tokës bujqësore, të shoqëruar me materialin hartografik, ku janë pasqyruar përdoruesit faktikë të tokës bujqësore, vendndodhja e saj, sipërfaqja dhe kufitarët për çdo ngastër.

11. Njësia e qeverisjes vendore ua dërgon, zyrtarisht, materialin hartografik dhe relacionin përmbledhës, të përgatitur sipas pikës 10, të këtij vendimi, institucioneve të mëposhtme dhe u kërkon:

a) Zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të përcaktojë gjendjen aktuale të pronësisë për të gjitha ngastrat e tokës bujqësore, të paraqitura në materialin hartografik;

b) Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t përcaktimin, në materialin hartografik, të sipërfaqeve të parcelave që janë miratuar ose janë në proces miratimi për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objektit pa leje, si dhe ato që janë përjashtuar nga legalizimi;

c) Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të përcaktojë, për të gjitha ngastrat e tokës bujqësore, të paraqitura në materialin hartografik, nëse janë apo jo objekt kërkesë, e cila po shqyrtohet prej saj, por nuk është dhënë ende vendim;

ç) DAMT-it, pranë këshillit të qarkut, të përcaktojë, për të gjitha ngastrat e tokës bujqësore, të paraqitura në materialin hartografik, nëse janë:

i) të miratuara, me vendim të Këshillit të Ministrave, në fondin e kompensimit fizik dhe janë vënë në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;

ii) të përfshira në veprimtarinë eksperimentale-shkencore të institucioneve kërkimore-shkencore. Për këtë informacion, kryetari i komunës/bashkisë i drejtohet edhe Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore;

iii) në përdorim të ndërmarrjeve të përbashkëta. Për këtë informacion kryetari i njësies së qeverisjes vendore i drejtohet edhe Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë.

d) Drejtorisë së Urbanistikës, pranë këshillit të qarkut, të përcaktojë, për të gjitha ngastrat e tokës bujqësore, të paraqitura në materialin hartografik, nëse gjenden ose jo brenda:

i) vijës kufizuese të ndërtimit të fshatit apo qytetit, sipas pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”, të ndryshuar;

ii) vijës kufizuese të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin, në bazë të vendimit nr. 88, datë 1.3.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit”, të ndryshuar, në përputhje me pikën 2, të nenit 2, të ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995, të ndryshuar;

iii) sipërfaqeve të tokës bujqësore që, me vendim të Këshillit të Ministrave apo me vendime të KRRTSH/KKT-së nuk janë më të tilla.

dh) Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të përcaktojnë, për të gjitha ngastrat e tokës bujqësore, të paraqitura në materialin hartografik, nëse janë dhënë me qira, në bazë të ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave që janë pasuri shtetërore”, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, ose kanë kaluar në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, me destinacion dhënien me qira, sipas vendimit nr. 45, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-shkencore, të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.”

12. Institucionet e përcaktuara në pikën 11, të këtij vendimi, kanë detyrimin t'i përgjigjen, me shkrim, njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e marrjes së kërkesës. Në çdo rast të mosrespektimit të afatit të mësipërm, prefekti i qarkut njofton ministrat përgjegjës që mbulojnë fushat e veprimtarisë së këtyre institucioneve.

13. Njësia e qeverisjes vendore, brenda 10 (dhjetë) ditëve pas marrjes së përgjigjeve nga institucionet e përmendura në pikën 11, të këtij



vendimi, dhe bazuar në të dhënat e këtij dokumentacioni, përgatit dhe i përcjell këshillit të njësisë së qeverisjes vendore relacionin përfundimtar, të shoqëruar me:

a) listën e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore;

b) listën e subjekteve përfituese, të cilat plotësojnë kushtet ligjore për t'u pajisur me AMTP;

c) sipërfaqen e përgjithshme të tokës, të përlogartitur për çdo subjekt përfitues, sipas përcaktimeve të pikës 1 e 2, të nenit 3, të ligjit nr. 171/2014, të detajuar edhe sipas ngastrave, si dhe kufizimet e kufitarët për çdo ngastër.

14. Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, përcakton me vendim, të marrë në përputhje me pikën 4, të nenit 33, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, emrat e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore për çdo fshat, në njësinë e qeverisjes vendore, si dhe emrat e subjekteve përfituese që plotësojnë kushtet ligjore për t'u pajisur me AMTP, vendndodhjen e tokës, sipërfaqen, kufizimet dhe kufitarët për çdo ngastër, të shoqëruar me hartën kadastrale, si pjesë përbërëse të tij, dhe me relacion të hollësishëm.

15. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, në çdo rast, në përgjegjësinë e tij, i dërgon mendimin e argumentuar, brenda 5 (pesë) ditëve, prefektit të qarkut, nëse është dakord apo kundër vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore vlerëson nëse në listën e subjekteve përfituese, të miratuar nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, janë përfshirë subjekte që nuk plotësojnë kushtet, sipas ligjit, apo janë përjashtuar subjekte që i plotësojnë ato. Mendimi i tij për parregullsitë e konstatuara shoqërohet edhe me dokumentacionin provues.

16. Prefekti shprehet për rregullshmërinë ligjore të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, në përputhje me pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002, "Për prefektin", pasi ka marrë mendimin e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, brenda afatit të përcaktuar në pikën 14, të këtij vendimi. Në rastet kur këshilli i njësisë së qeverisjes vendore ka marrë vendim në periudhën 1 tetor 2013 deri

në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", prefekti i qarkut do të shprehet për rregullshmërinë ligjore të këtij vendimi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 57/2012, "Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore".

17. Vendimi i këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, pasi ndjek procedurat ligjore për miratim nga prefekti i qarkut, afishohet menjëherë në vende publike të njësisë së qeverisjes vendore dhe u përcillet, zyrtarisht, institucioneve që merren me drejtimin dhe kontrollin e procesit të verifikimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, si:

a) Komisionit Qeveritar të Tokës dhe sekretariatit teknik pranë tij;

b) Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, pranë prefektit të qarkut;

c) DAMT-it, pranë këshillit të qarkut;

ç) Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

18. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, brenda 7 (shtatë) ditëve pas realizimit të procedurave ligjore për miratimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore nga prefekti i qarkut, formon dosjen e secilit përfitues, e cila përmban:

a) certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile e njësisë së qeverisjes vendore, ku pasqyrohet numri i anëtarëve të familjes përfituese ose individit, në favor të të cilit do të lëshohet AMTP-ja, sipas gjendjes më 1 gusht 1991, me ndryshimet deri më 1 tetor 1992, të cilët nuk kanë ndryshuar vendbanimin e tyre që prej kësaj date;

b) dokumentacionin që vërteton se është përfitues i tokës bujqësore në pronësi, si rezultat i lëvizjes nga qendra e tij e banimit, me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave;

c) dokumentacionin kadastral, hipotekor, arkivor apo gjyqësor që provon pronësinë mbi tokën bujqësore para reformës agrare dhe që vërteton se është përfitues i tokës bujqësore në pronësi, si bashkëthemelues i ish-ndërmarrjes bujqësore, si dhe certifikatën e gjendjes familjare në kohën e dorëzimit të tokës bujqësore;



ç) planvendosjen e ngastrës/ave që subjekti përfitues përdor për qëllime bujqësore, me nënshkrimin e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore dhe të vulosur me vulën e njësisë së qeverisjes vendore;

d) korrespondencën shkresore të realizuar me institucionet, sipas pikës 11, të këtij vendimi.

19. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore plotëson AMTP-të për subjektet përfituese, të përcaktuara në vendimin e këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, i cili është konfirmuar si në përputhje me ligjin nga prefekti i qarkut.

20. AMTP-ja plotësohet në 4 (katër) kopje origjinale, për çdo ngastër të dhënë në pronësi. Në këtë dokument shkruhen të gjithë bashkëpronarët dhe pjesa e tyre e bashkëpronësisë.

21. AMTP-ja ka ngjyrë të verdhë dhe përmban të gjitha elementet dhe formën, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Këto akte prodhohen me shpenzimet e njësisë së qeverisjes vendore, sipas modelit të AMTP-së, i cili merret zyrtarisht në Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, pranë prefektit të qarkut. Njësia e qeverisjes vendore është e detyruar të përdorë vetëm këtë model.

22. Secila kopje e AMTP-së shoqërohet, bashkëlidhur, me planvendosjen e ngastrës, të përgatitur nga një subjekt i licencuar, sipas kërkesave të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku pasqyrohen sipërfaqja, kufijtë e saj dhe kufitarët, dhe përmban nënshkrimin dhe vulën e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore.

23. Njësia e qeverisjes vendore mban një regjistër të veçantë për secilin fshat, për regjistrimin e AMTP-ve që ajo lëshon, i cili përmban emrat e subjekteve përfituese të tokës bujqësore, vendndodhjen e saj, sipërfaqen, kufijtë dhe kufitarët për çdo ngastër, sipas lidhjes 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Regjistrat përgatiten nga vetë njësitë e qeverisjes vendore. Çdo fletë (jo faqe) të ketë numrin e saj rendor, që, për çdo fshat, fillon gjithmonë nga numri 1. Pas përgatitjes, regjistrat i dërgohen prefektit të qarkut, i cili nënshkruan e vulos të gjitha fletët, bashkë me kopertinën. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore dhe prefekti i qarkut mbajnë procesverbal ku pasqyrojnë sa regjistra dhe me nga sa fletë u nënshkruan. Procesverbali mbahet në dy kopje, të cilat ruhen një në njësinë e qeverisjes vendore dhe një në prefekturë.

Regjistri i çdo fshati, së bashku me hartën përmbledhëse, ku janë të pasqyruara të dhënat për të gjitha ngastrat e kaluara në pronësi, arkivohet.

24. Njësia e qeverisjes vendore arkivon një kopje të AMTP-së, të shoqëruar me planvendosjen e saj dhe dokumentacionin përkatës, sipas pikës 18, të këtij vendimi. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga plotësimi i AMTP-ve, në bazë të procedurave të njoftimit, sipas ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i dërgon, me shkresë, përfituesit/përfaqësuesit me prokurë të përfituesve, AMTP-në, të shoqëruar me planvendosjen, për secilën ngastër.

25. Çdo ankim për AMTP-të, nga individë apo institucione, kur vlerësohet se ato janë krijuar në kundërshtim me ligjin, paraqitet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KV), pranë prefektit të qarkut, duke vënë në dijeni kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore. KV-ja merr vendim për ankimet dhe njofton, menjëherë, ankuesin dhe kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore.

26. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit të ankimit, u dërgon, me shkresë, AMTP-të, të shoqëruara me planvendosjet për secilën ngastër,:

a) kërkuarit/përfaqësuesit me prokurë të përfituesve;

b) DAMT-it, pranë këshillit të qarkut, për evidentimin e pronësisë së re mbi tokën bujqësore;

c) ZVRPP-së përkatëse, për të kryer procesin e regjistrimit në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme.

27. ZVRPP-ja, pasi verifikon vetëm elementet formale të AMTP-ve të paraqitura për regjistrim, procedon brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga data e marrjes së tyre. Kur regjistrimi fillestar nuk kryhet nga vetë ZRPP-ja, kjo e fundit, brenda 5 (pesë) ditëve, vë aktet në dispozicion të subjekteve të kontraktuara për të kryer procedurën e regjistrimit fillestar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.



28. Nëse ZVRPP-ja, gjatë verifikimit formal, konstaton praktika abuzive apo korruptive të organeve të qeverisjes vendore, paraqet, menjëherë, kallëzim penal në prokurorinë kompetente.

29. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore raporton, çdo muaj, për ecurinë e kryerjes së këtij procesi dhe, në përfundim të tij, te prefekti i qarkut.

30. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Drejtësisë, Komisioni Qeveritar i Tokës, komisionet vendore të vlerësimit të titujve të

pronësisë, pranë prefekturave, Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, prefektët, njësitë e qeverisjes vendore, drejtoritë e administrimit e mbrojtjes së tokës, drejtoritë e urbanistikës, pranë këshillave të qarqeve, zyrtat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, drejtoritë rajonale të ALUIZNI-t dhe drejtoritë rajonale të bujqësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

		Lidhja 1
REPUBLIKA E SHQIPËRISË		
KOMUNA _____	VENDIMI I KËSHILLIT TË KOMUNËS NR. _____, DATË _____	
BASHKIA _____	BASHKISË	
FSHATI _____	AKTI NR. _____, DATË _____	
 AKTI I MARRJES SË TOKËS BUJQËSORE NË PRONËSI 		
Në zbatim të ligjit nr. 171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi përfituesve”, Zotërinjtë:		
1. _____	6. _____	
2. _____	7. _____	
3. _____	8. _____	
4. _____	9. _____	
5. _____	10. _____	
U jepet në pronësi, në pjesë të barabarta, pasuria më poshtë:		
Lloji i pasurisë: _____		
Sipërfaqja e pasurisë: _____		
Zona Kadastrale: _____		
Numri kadastral sipas hartës së shkallës 1 : 5000 _____		
Numri kadastral sipas hartës së shkallës 1 : 2500 _____		
Emërtimi i ngastrës : _____		
Kufizimet e pasurisë:	Veriu: _____	
	Jugu: _____	
	Lindja: _____	
	Perëndimi: _____	
KRYETARI I KOMUNËS/BASHKISË		VULA
_____ Emër, mbiemër, firmë		
Akti i Marrjes së Tokës Bujqësore në Pronësi është i vlefshëm bashkë me planvendosjen e ngastrës. Ky akt bëhet në katër kopje origjinale, nga të cilat një i dorëzohet përfituesit, një arkivohet në komunë/bashki, një i dërgohet DAMT-së dhe një dërgohet për regjistrim në ZVRPP.		



Emër, mbiemër dhe firma e Prefektit

Vula e Prefekturës



Lidhja 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMUNA _____

BASHKIA _____

FSHATI _____

REGJISTRI I AKTEVE TË MARRJES SË TOKËS BUJQËSORE NË PRONËSI

Dhënë

në zbatim të Ligjit nr. 171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve" dhe të VKM nr. _____, datë _____ "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore kalimit në pronësi të përfituesve"



Emër, mbiemër dhe firma e Prefektit

Vula e Prefekturës

Fleta 1

Akti i Marrjes së Tokës Bujqësore në Pronësi nr. _____, datë _____
Numri i aktit duhet të përputhet me numrin e fletës së regjistrit.

Pronarët

- | | |
|----------|-----------|
| 1. _____ | 6. _____ |
| 2. _____ | 7. _____ |
| 3. _____ | 8. _____ |
| 4. _____ | 9. _____ |
| 5. _____ | 10. _____ |

Pasuria Lloji i pasurisë: _____

Sipërfaqja e pasurisë: _____

Zona Kadastrale: _____

Numri kadastral sipas hartës së shkallës 1 : 5000 _____

Numri kadastral sipas hartës së shkallës 1 : 2500 _____

Emërtimi i ngastrës : _____

Kufizimet e pasurisë: Veriu: _____

Jugu: _____

Lindje: _____

Perëndimi: _____

PUNONJËSI I ZAMT**PUNONJËSI I ARKIVIT**_____
Emër, mbiemër, firmë_____
Emër, mbiemër, firmë**KRYETARI I KOMUNËS/BASHKISË**_____
Emër, mbiemër, firmë



Emër, mbiemër dhe firma e Prefektit

Vula e Prefekturës

Fleta 2

Akti i Marrjes së Tokës Bujqësore në Pronësi nr. _____, datë _____
 Numri i aktit përputhet me numrin e fletës së regjistrit.

Pronarët

- | | |
|----------|-----------|
| 1. _____ | 6. _____ |
| 2. _____ | 7. _____ |
| 3. _____ | 8. _____ |
| 4. _____ | 9. _____ |
| 5. _____ | 10. _____ |

Pasuria Lloji i pasurisë: _____

Sipërfaqja e pasurisë: _____

Zona Kadastrale: _____

Numri kadastral sipas hartës së shkallës 1 : 5000 _____

Numri kadastral sipas hartës së shkallës 1 : 2500 _____

Emërtimi i ngastrës : _____

Kufizimet e pasurisë: Veriu: _____

Jugu: _____

Lindje: _____

Perëndimi: _____

PUNONJËSI I ZAMT**PUNONJËSI I ARKIVIT**_____
Emër, mbiemër, firmë_____
Emër, mbiemër, firmë**KRYETARI I KOMUNËS/BASHKISË**_____
Emër, mbiemër, firmë



Emër, mbiemër dhe firma e Prefektit

Vula e Prefekturës

Fleta 3

Akti i Marrjes së Tokës Bujqësore në Pronësi nr. _____, datë _____
 Numri i aktit përputhet me numrin e fletës së regjistrit.

Pronarët

- | | |
|----------|-----------|
| 1. _____ | 6. _____ |
| 2. _____ | 7. _____ |
| 3. _____ | 8. _____ |
| 4. _____ | 9. _____ |
| 5. _____ | 10. _____ |

Pasuria Lloji i pasurisë: _____

Sipërfaqja e pasurisë: _____

Zona Kadastrale: _____

Numri kadastral sipas hartës së shkallës 1 : 5000 _____

Numri kadastral sipas hartës së shkallës 1 : 2500 _____

Emërtimi i ngastrës : _____

Kufizimet e pasurisë: Veriu: _____

Jugu: _____

Lindje: _____

Perëndimi: _____

PUNONJËSI I ZAMT**PUNONJËSI I ARKIVIT**_____
Emër, mbiemër, firmë_____
Emër, mbiemër, firmë**KRYETARI I KOMUNËS/BASHKISË**_____
Emër, mbiemër, firmë

**VENDIM****Nr. 338, datë 22.4.2015****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 253, DATË 6.3.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË
PLOTËSIMIT TË AKTEVE TË MARRJES
SË TOKËS BUJQËSORE NË PRONËSI
PËR FAMILJET BUJQËSORE NË
FSHATRA TË ISH-KOOPERATIVAVE
BUJQËSORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 253, datë 6.3.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Kudo në vendim:

a) emërtimi “...Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit...” zëvendësohet me emërtimin “...Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ...”;

b) fjalët “...komuna/bashkia...” zëvendësohen me fjalët “...njësia e qeverisjes vendore ...”;

2. Në pikën 10 shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të përcaktojë, për të gjitha ngastrat e tokës bujqësore, të paraqitura në materialin hartografik, nëse janë në fondin e kompensimit fizik në dispozicion të kësaj agjencie.”

3. Në pikën 15 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Prefekti i qarkut duhet të shprehet mbi rregullshmërinë ligjore të çdo vendimi të marrë nga këshilli i njësive të qeverisjes vendore në periudhën 1 janar 2014 deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 172/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.”.

Faqe | 2980

4. Në pikën 16 shtohet shkronja “ç”, si më poshtë vijon:

“ç) Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.”.

5. Në pikën 30, emërtimi “...Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit...” hiqet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama****VENDIM****Nr. 339, datë 22.4.2015****PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE
PËRBËRËSE, MËNYRËS SË
VENDOSJES DHE AFATIT TË
LËSHIMIT TË PULLËS SË
KONTROLLIT TË BARIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 20, të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Barnat që hidhen në treg dhe qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë kanë të vendosur, mbi kutinë e ambalazhit, pullën e kontrollit të barnave.

2. Pulla e kontrollit të barnave provon se bari është pajisur me autorizimin për tregtim dhe i është vendosur çmimi përfundimtar i shitjes.

3. Me pullën e kontrollit të barnave pajisen të gjithë prodhuesit, në Republikën e Shqipërisë, që prodhojnë barna, me destinacion tregun vendas, dhe të gjitha subjektet që, sipas ligjit, importojnë barna, me destinacion tregun vendas.

4. Pulla e kontrollit të barnave përmban, në mënyrë të detyrueshme, këto të dhëna:

a) emërtimin e barit;

b) formë-dozën;

c) serinë e prodhimit të barit;

ç) emrin e fabrikuesit/importuesit të barit në Republikën e Shqipërisë;

d) çmimin e shitjes me pakicë të barit;

dh) emërtimin e autoritetit që emeton pullën: Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.



5. Pulla e kontrollit vendoset, nga prodhuesit dhe importuesit e barnave, mbi kutinë e ambalazhit të barit.

6. Bari duhet të pajiset me pullën e kontrollit brenda një periudhe kohore prej 15 ditësh kalendarike, pas përfundimit të procedurës doganore në Republikën e Shqipërisë, për barnat e importuara, dhe pas paraqitjes së kërkesës, nga prodhuesit vendas.

7. Agjencia e lëshimit të pullës së kontrollit të barnave ka këto detyra:

a) bën verifikimin fizik të barnave të importuara/prodhuara në vend, pranë ambienteve të subjektit, në prani të inspektorit farmaceutik;

b) bën verifikimin e të dhënave të barit të importuar/prodhuar në vend me barin e autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, pranë Agjencisë;

c) bën verifikimin e çmimit të barit të importuar/prodhuar në vend, në bazë të legjislacionit përkatës për përcaktimin e çmimeve të barnave;

ç) jep autorizimin e përdorimit të barnave, në bazë të rregullave të përcaktuara nga ministri përgjegjës për Shëndetësinë;

d) lëshon pullën e kontrollit të barnave.

8. Hedhja në treg, shitja me shumicë e me pakicë e barnave, nga subjektet, pa pullën e kontrollit, përbën shkelje të rregullave të fabrikimit e të tregtimit dhe ndëshkohet sipas shkronjës “ç”, të nenit 63, të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”.

9. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 340, datë 22.4.2015

PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I MUZEUT “MARUBI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e

Shqipërisë”, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkëfinancimin, në vlerën e përgjithshme 55 000 000 (pesëdhjetë e pesë milionë) lekë, për realizimin e zbatimit të projektit “Rikonstruksioni i muzeut “Marubi””, si pjesë e projektit HERA – menaxhimi i turizmit të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore në zonën e Adriatikut, bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, nëpërmjet komponentit IPA të bashkëpunimit ndërkufitar, dhe nga Fondi Shqiptaro-Amerikan.

2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i shtohet vlere e bashkëfinancuar nga qeveria shqiptare, e shtrirë në vite, si më poshtë vijon:

a) Për vitin 2015, i shtohet fondi prej 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë lekësh, i ndarë sipas zërave:

i) Zëri “Kosto lokale”, kapitulli “03”, fondi prej 11 670 000 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) lekësh;

ii) Zëri “TVSH dhe taksë doganore”, kapitulli “04”, fondi prej 2 330 000 (dy milionë e treqind e tridhjetë mijë) lekësh.

b) Për vitin 2016, i shtohet fondi prej 41 000 000 (dyzet e një milionë) lekësh, i ndarë sipas zërave:

i) Zëri “Kosto lokale”, kapitulli “03”, fondi prej 34 167 000 (tridhjetë e katër milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekësh;

ii) Zëri “TVSH dhe taksë doganore”, kapitulli “04”, fondi prej 6 833 000 (gjashtë milionë e tetëqind e tridhjetë e tre mijë) lekësh.

3. Efekti financiar sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit i vitit 2015.

4. Efektet financiare sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të parashikohen dhe të planifikohen në planin e buxhetit për vitin 2016.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 341, datë 22.4.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, TË CILËT PREKEN NGA
RIKONSTRUKSIONI I BULEVARDIT
“OSUMI”, FAZA E PARË, NË BASHKINË
E BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për rikonstruksionin e bulevardit “Osumi”, faza e parë, në Bashkinë e Beratit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Beratit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, sipas vlerës përkatëse për sipërfaqen prej 87 (tetëdhjetë e

shtatë) m², “ndërtesë”, në vlerën e përgjithshme 2 830 197 (dy milionë e tetëqind e tridhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 2 830 197 (dy milionë e tetëqind e tridhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Beratit, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Beratit.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Beratit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 87 (tetëdhjetë e shtatë) m², “ndërtesë”, për rikonstruksionin e bulevardit “Osumi”, faza e parë, të bëhet në favor të Bashkisë së Beratit.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat dhe Bashkia e Beratit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN
“PËR RIKONSTRUKSIONIN E BULEVARDIT OSUMI, FAZA E PARË”
BASHKIA BERAT**

Nr	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Ndërtesë sip/m ²	Çmimi/lekë	Vlefte/lekë	Nr. kadastral	Zëri kadastral	Lloji i dokumentit
1	Niazi Sherif Ajazi	8502	87	32 531	2 830 197	11/5.	Ndërtesë	Vërtetim pronësie
	Totali				2 830 197			

**VENDIM****Nr. 342, datë 22.4.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, TË CILËT PREKEN NGA
RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS “UNAZA
E JASHTME E QYTETIT”, SI DHE
SISTEMIMI I RRUGËS TE LAGJJA
“CFAKE” PRANË KASAPIT, NË
BASHKINË E GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës “Unaza e jashtme e qytetit”, si dhe sistemimi i rrugës te lagjja “Cfake” pranë kasapit, në Bashkinë e Gjirokastrës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Gjirokastrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, sipas vlerës përkatëse për sipërfaqet prej 1 931 (një mijë e nëntëqind e tridhjetë e një mijë) m², “truall”, dhe 887 (tetëqind e tetëdhjetë e shtatë) m², “kullotë

pyjore” e “zallishte”, në vlerën e përgjithshme prej 9 527 143 (nëntë milionë e pesëqind e njëzet e shtatë mijë e njëqind e dyzet e tre) lekësh, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 9 527 143 (nëntë milionë e pesëqind e njëzet e shtatë mijë e njëqind e dyzet e tre) lekësh të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Gjirokastrës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Gjirokastrës.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Gjirokastrës të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 1 931 (një mijë e nëntëqind e tridhjetë e një mijë) m², “truall”, dhe 887 (tetëqind e tetëdhjetë e shtatë) m², “kullotë pyjore” e “zallishte”, për rikonstruksionin e rrugës “Unaza e jashtme e qytetit”, si dhe sistemimin e rrugës te lagjja “Cfake” pranë kasapit, të bëhet në favor të Bashkisë së Gjirokastrës.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë dhe Bashkia e Gjirokastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË TË SHPRONËSIMIT, QË DO TË PËRDORET PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS “UNAZA E JASHTME E QYTETIT”, SI DHE SISTEMIMI I RRUGËS TEK LAGJIA “CFAKE” PRANË KASAPIT

BASHKIA GJIROKASTËR

Nr	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Truall/m ²	Tokë bujqësore, kullotë pyjore, zallishte m ²	Çmimi lek/m ² truall, tokë bujqësore, kullotë pyjore, zallishte m ²	Vlefte/lekë	Nr. i pasurisë	Lloji i dokumentit
1	Aferdita Kallfa (Dono)	8541		42	164	6888 00	20/74	Vërtetim pronësie
2	Neim Nishani Arben Nishani Valbona Nishani Dianan Nishani	8541		685	164	112 340 00	20/75	Vërtetim pronësie
3	Maksimilian Shehu Melsi Shehu Mirgel Shehu	8541		90	85	7 650 00	20/95	Vërtetim pronësie
4	Artur Shehu	8541		70	85	5 950 00	20/94	Vërtetim pronësie
5	Fatos Shehu	8541	218		4865	1 060 570 00	20/83	Vërtetim pronësie
6	Astrit Kallfa	8541	293		4865	1 425 445 00	35/151	Vërtetim pronësie



	Muzafer Kallfa							
7	Astrit Kallfa Muzafer Kallfa	8541	462		4865	2 247 630 00	35/152	Vërtetim pronësie
8	Florika Mezini Manushaqe Mezini Nakie Mezini Nafiz Mezini	8541	340		4865	1 654 100 00	17/68	Vërtetim pronësie
9	Ymer Gega Dashmir Gega Lida Gega Perlat Gega Roland Gega	8543	618		4865	3 006 570 00	5/91,	Vërtetim pronësie
	Totali		1931			9 527 143 00		

VENDIM**Nr. 343, datë 22.4.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I LINJËS SË TRANSMETIMIT 110 KV,
UZNOVË - ÇOROVODË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kV, Uznovë - Çorovodë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen prej 2 117 (dy mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) m², tokë bujqësore, arë dhe

kullotë, vlerësuar në shumën 217 351 (dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e një) lekë.

4. Fondi prej 217 351 (dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e një) lekësh të përballohet nga fondet e OST, sh.a.-së.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit të përballohet nga OST sh.a.-ja, si subjekti që garanton shpenzimet për realizimin e këtij procesi.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit prill 2015.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Berat e Skrapar të pezullojnë të gjitha transaksionet mbi këto pasuri deri në përfundim të procesit të kalimit të pronësisë së pasurive të shpronësuar në favor të OST, sh.a.-së.

8. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë, OST, sh.a.-ja, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Berat e Skrapar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS
110 KV UZNOVË – ÇOROVODË
Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: tokë arë, truall, kullotë

Nr.	Numri i shtyllës	Të dhëna për pronësinë							Sip. Shpronësim për shtyllë m ²	Vlera e shpronësimit në lek/m ²	Vlera e shpronësimit në leke për shtyllë	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. kadastral	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia Sip pronës m ²				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11	12	14	15
Bashkia BERAT												
1	5	Ruzhdi	Xhevdet	Gega	8504	168/26	arë	1950	47			
2	6	Pretendues			8504	276/2	arë	7389	39			
3	7	Bashkim	Veli	Selimi	8504	172/29	arë	1500	33			
3	7	Estreh	Gani	Cela	8504	178/23	arë	1551				
4	8	Petrit	Myrto	Derrasa	8504	179/33	arë	1695	33			
5	9	Veli	Sabri	Selimi	8504	172/29	arë	4046	88			
6	10	Myrteza	Azis	Leka	8504	255/140	arë	4100	33			
7	11	Isuf	Ysen	Leka	8504	255/142	arë	2650	73			
8	12	Leonidha	koli	Papa	8504	247/12	arë	3520	33			
9	13	Isa	Beqir	Toska	8504	330/4	arë	12650	33			
KOMUNA VERTOP												
Fshati VODICE												
10	14	Xhevdet	Sulo	Ruci	3808	334/9	arë	4250	80	203	16240	
11	15	Vexhi	Muharem	Toska	3808	343/30	arë	30000	63	203	12789	
12	16	Lavdosha	Shyqiri	Danushi	3808	330/127	arë	500	68	203	13804	
13	17	Myrteza	Avdyl	Hoxha	3808	330/196	arë	6600	40	203	8120	
13	17	Agim	Avdyl	Hoxha	3808	330/237	arë	6500				
14	19	Adem	Kadri	Cela	3808	437/8	arë	4500	73	203	14819	
15	20	Xhevair	Halil	Cela	3808	412/12	arë	9620	61	203	12383	
16	21	Pelivan	Haki	Cela	3808	412/33	arë	4650	33	203	6699	
17	22	Neim	Neki	Loca	3808	412/72	arë	1700	68	203	13804	
Fshati BREGAS												
18	23	Asqeri	Fasli	Demiri	1270	10/11	arë	1300	40	111	4440	
19	24	Tatiko	Dule	Stoceni	1270	10/13	arë	1750	107	111	11877	
20	26	Sami	Bedri	Rama	1270	35/2	arë	1930	39	111	4329	
21	27	Dilaver	Sejdi	Dushku	1270	38/14	arë	560	39	111	4329	
22	28	Perparim	Estref	Cela	1270	71/1	arë	1650	33	111	3663	
Fshati Fushe PESHTAN												
23	31	Ferbert		Salillari	2935	145/8	arë	1920	33	111	3663	
24	33	Myrteza	Avdyl	Salillari	2935	195/1	arë	15000	47	111	5217	
Fshati MBRAKULL												
25	38	Myslim	Hysen	Boduri	2632	36/17	arë	5200	89	111	9879	
26	39	Gramoz	Neim	Muco	2632	36/11	arë	5800	40	111	4440	
27	41	Valentina		Luka	2632	268/8	arë	840	61	111	6771	
27	41	Pretendues			2632	268/9	arë	460				
28	42	Myslym	Sadik	Nurellari	2632	265/14	arë	2100	39	111	4329	
BASHKIA Polican												
N.B POLICAN												
29	45	Skender		Duka	3019	32/16	arë	9250	47			
30	50	Pretendues			3019	91/8	arë	14170	39			
31	51	Dervish		kalluci	3019	93/13	arë	2850	40			
KOMUNA BOGOVË												
Fshati NISHOVË												
32	55	Neki		Zylyftari	2804	114	arë	2350	68	106	7208	
Fshati SELAN												
33	65	Petrit		Cuni	3274	315	arë	2031	68	106	7208	
34	69	Nezir		Shania	3274	123	arë	10895	33	106	3498	
35	74	Haki		Ymerali	3274	93	arë	2856	68	106	7208	
36	75	Enver		Ymerali	3274	196	arë	7835	45	106	4770	
37	77	Cane		Ymerali	3274	193	arë	4431	40	106	4240	
38	78	Cane		Ymerali	3274	193	arë	2400	52	106	5512	
KOMUNA QENDËR Polican												
Fshati STRORE												
39	79	Kalem		Hysko	3531	99	arë	8000	80	106	8480	
40	80	Sefer		Zyla	3531	93/17	arë	6000	39	106	4134	
41	81	Flamur		Nano	3531	93/14	arë	10000	33	106	3498	
Sipërfaqe totale për shpronësim në m ²									2117			
Shuma totale në lekë për shpronësim											217351	

**UDHËZIM****Nr. 15, datë 8.4.2015**

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 1, DATË 2.2.2015 “MBI
ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 8, DATË
14.1.2015 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE PËR MBROJTJEN E
SHTRESAVE NË NEVOJË, NGA HEQJA
E FASHËS DERI NË 300 KWH PËR
FATURIMIN E ÇMIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në zbatim të pikës 6 të vendimit nr.8, datë 14.1.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj” dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj kryefamiljarëve që marrin pension pleqërie ose pension invaliditeti të cilët paraqesin deklaratat dhe dokumentet për përfitimin e kompensimit të çmimit të energjisë elektrike, si dhe për të përballuar fluksin e kërkesave të pranimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit, Ministri i Energjisë dhe Industrisë, Ministri i Financave dhe Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

UDHËZOJNË:

1. Në pikën 4 të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 2.2.2015, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 8, datë 14.1.2015 të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike, data 27.4.2015 bëhet 25.6.2015.

2. Germa “c” e pikës 2 të kreut I, germa “c” e pikës 1 të kreut II dhe germa “c” e pikës 1 të kreut III shfuqizohen.

3. Pas gërmës “d” të pikës 2 të kreut I, shtohet germa “e” me përmbajtje:

“Fotokopje e vërtetimit të KMCAP”

4. Pas paragrafit të fundit të kreut III shtohet paragrafi me përmbajtje:

“Marrëdhënia e punësimit apo vetëpunësimit të anëtarëve të familjes vërtetohet përmes deklaratimit nga përfituesi dhe në vazhdimësi do të jetë objekt i verifikimit nga institucionet një bashkëpunim me njëri-tjetrin”.

5. Ngarkohet Ministria e Financave, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Sociale dhe Rinisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.2.2015.

MINISTRI I FINANCAVE**Shkëlqim Cani****MINISTRI I ENERGJISË DHE INDUSTRIË****Damian Gjicknuri****MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE
RINISË****Erion Veliaj****VENDIM****Nr. 41, datë 7.4.2015**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
TRANSFERIMIN E LICENCËS SË
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË “EURON
ENERGY GROUP” SHPK, MIRATUAR
ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERVE TË ERE-S NR. 87,
DATË 26.9.2011, TEK SHOQËRITË “ALB-
ENERGY” SHPK, “EURON ENERGY”
SHPK DHE “ENERGAL” SHPK**

Në mbështetje të nenit 20, të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 7, nenit 149 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar; si dhe nenit 4, nenit 17 pika 1, pika 3, 4 dhe pika 5, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 7.4.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin nr. 87, datë 26.9.2011 të Bordit të Komisionerve të ERE-s për miratimin e transferimit të licencës së prodhimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k. tek shoqëritë “Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k., si edhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,



konstatoi se:

Nga dokumentacioni i paraqitur në ERE nga shoqëritë “Euron Energy Group” sh.p.k., “Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k., sipas nenit 17 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, rezultoi:

Shoqëria “Euron Energy Group” sh.p.k.,

Neni 17, pika 4 germa “a”: Format i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, i plotësuar në mënyrë korrekte; germa b : Informacioni, ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës i plotësuar në mënyrë korrekte; germa “c”: vendimin me shkrim në organet drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës, plotësuar në mënyrë korrekte.

Shoqëria “Alb-Energy” sh.p.k.,

Neni 17, pika 2 germa “a”: Format i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, plotësuar në mënyrë korrekte; germa “b”: Dokumentet juridike administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2 plotësuar në mënyrë korrekte; germa “c”: Dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3 (shoqëria “Alb-Energy” sh.p.k., është shoqëri e sapokrijuar); germa “d”: I plotësuar në mënyrë korrekte.

Shoqëria “Euron Energy” sh.p.k.,

Neni 17, pika 2 germa a: Format i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, plotësuar në mënyrë korrekte; germa “b”: Dokumentet juridike, administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2 plotësuar në mënyrë korrekte; germa “c”: Dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3 (shoqëria “Euron Energy” sh.p.k., është shoqëri e sapokrijuar); germa “d”: I plotësuar në mënyrë korrekte.

Shoqëria “ENERGAL” sh.p.k.,

Neni 17, pika 2 germa “a”: Format i aplikimit sipas neni 9, pika 1 plotësuar në mënyrë korrekte; germa “b”: Dokumentet juridike administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2 plotësuar në mënyrë korrekte; germa “c”: Dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3 (shoqëria “Energal” sh.p.k., është shoqëri e sapokrijuar); germa “d”: plotësuar në mënyrë korrekte.

Meqenëse licenca e tregtimit nuk mund të transferohet njëkohësisht në tre subjekte të ndryshme, do të komunikohet me shoqëritë e mësipërme që licenca e shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k. t’i transferohet vetëm njërit nga

subjektet, apo secili nga subjektet “Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k. që do të aplikojë në ERE për pajisjen me licencë tregtimi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Euron Energy Group”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr. 87, datë 26.09.2011, tek shoqëria “Alb-Energy” sh.p.k.

2. Fillimin e procedurave për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Euron Energy Group”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr. 87, datë 26.9.2011, tek shoqëria “Euron Energy” sh.p.k.

3. Fillimin e procedurave për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Euron Energy Group”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr. 87, datë 26.09.2011, tek shoqëria “Energal” sh.p.k.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit ngarkohet për njoftimin e shoqërive “Euron Energy Group” sh.p.k., “Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” dhe “Energal” sh.p.k. për vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 42, datë 7.4.2015**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS ME NR.
138, SERIA PV11K PËR PRODHIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET
E “PELLGUT TË OKSHTUNIT”, ME
FUQI 31,489 MW, TË SHOQËRISË
“DITEKO” SHPK TË MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 114
DATË 16.11.2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 10, 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4 germat “a” dhe “b”, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.4.2015, mbasi shqyrtoji relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Diteko” sh.p.k., plotëson kërkesat ligjore siç kërkohen nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës. I plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: Mungon vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti, bazuar në nenin 10, pika 10, neni 11, pika 1 të rregullores “Për procedurat e

licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, t’i paraqesë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës me nr. 138, seria pv11k, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et e “Pellgut të Okshunit” me fuqi 31,489 MW, të shoqërisë “Diteko”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 114, datë 16.11.2011.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM**Nr. 43, datë 7.4.2015**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË
“PHOENIX PETROLEUM” SHA NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË GAZIT
NATYROR**

Në mbështetje të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, neni 14, pika 1, germa “ç”, si dhe neni 4, pika 1, germa “ç”; neni 8, neni 9 pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “d”; pika 2, germa “a” dhe nenin 10, të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 11.2.2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.4.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Phoenix Petroleum” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,



konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie plotëson pjesërisht kërkesat e ligjit si më poshtë vijon:

- Neni 9, pika 1, germa “a”
- Tipi i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 1, germa “b” është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 1, germa “c” është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale, plotësuar pjesërisht.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës, plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të neni 10, të “Rregullat dhe procedurat për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 9 datë 11.2.2011 të ERE-s, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror me shumicë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 44, datë 7.4.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KISI-BIO-ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KACNI”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”; 5 pika 1 germa “a”; 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.4.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, me fuqi totale 3,87 MW,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 9, pika 1- Format i aplikimit nuk është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2-Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 3- Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar pjesërisht.

- Neni 9, pik .1.1-Të dhëna specifike për HEC janë plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 4.1.2-Të dhënat për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin janë plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 4.1.3-Dokumentacioni teknik dhe grafik është plotësuar pjesërisht.

- Neni 9, pika 4.1.4-Dokumentacioni tekniko-ekonomik është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.5-Leje nga institucione të tjera, është plotësuar tërësisht.

Për dokumentacionet e munguara, do të



njoftohet subjekti në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kacni” me fuqi totale 3,87 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 45, datë 7.4.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “KISI-BIO- ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “g”; 5 pika 1 germa “g”; 8 dhe 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.4.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit,

modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1- Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2-Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 3 -Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 4/10, germa “a” - Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar, i paplotësuar.

- Neni 9, pika 4/10, germa “b”-Kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e aktivitetit i paplotësuar.

- Neni 9, pika 4/10, germa “c”- Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti rezulton se shoqëria “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., nuk ka realizuar kontrata të mëparshme me objekt tregtimin e energjisë elektrike.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 46, datë 7.4.2015

PËR RISHIKIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE TË OST SHA
PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 9, 24, dhe 64 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 9 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga te licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.4.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Rishikuar të Investimeve të OST sh.a. për vitin 2015 (bashkëlidhur këtij vendimi Plani i Investimeve).

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

Plani i rishikuar (Miratuar ne Prill 2015) i investimeve te OST sh.a (financuar me fondet e saj) per vitin 2015

Nr	Emertimi i investimit	Vendndodhja e investimit (Linja/Kyrtori/Komuna)	Grupimi (Linja, Niveli, etj)	Niveli i tensionit	Vlera e parashikuar (Eke)	Burimi i financimit		Perioda Grace	Norma e Interesit (%)	Perioda e Huse	Data e parashikuar per fillimin	Data e parashikuar per perfundimin	Vlera e realizuar (ose te perfunduar)	Data e perfundimit (ose te perfunduar)
						Kapit.Vitet	Hua							
1	Blerje Sisteme IT per Qender Backup / Disaster recovery	Tirane	IT	-	30,000,000	OST sh.a.								
2	Blerje Licenca Microsoft Server, Office, Windows, Baza te dhemsh etj	Tirane	IT	-	40,000,000	OST sh.a.								
3	Projektim, Nderim i dy Dhoma serveresh, profesionale me te gjitha elementet teknike perberes.	Tirane	IT	-	20,000,000	OST sh.a.								
4	Kompletimi i mbyrjes rreze per linjen kablore 110 kV Nivocioni Tirana 1 - Nivocioni Qender ,	Tirane	Nel. Transm.	110 kV	10,000,000	OST sh.a.								
5	Blerje aparate dhe pajise per kontrolle dhe nimbujet e pajisjeve te NGS				20,000,000	OST sh.a.								
6	Blerje aparate dhe pajise per kontrolle dhe nimbujet e sistemit te nimbujes rreze dhe automatikes				85,000,000	OST sh.a.								
7	Zgjerimi i sistemit te telekomunikacionit				80,000,000	OST sh.a.								
8	Mendimi i fuqise ne linjet e interkonexioneve				40,000,000	OST sh.a.								
9	Instalimi i llojeve optike ne linjet e transmetimit		Linje		80,000,000	OST sh.a.								
10	Demonstrimi dhe ndertimi i nje linje te re 110 kV Rreshbull - Kavaje.	Rash Kavaje	Linje	110 kV	250,000,000	OST sh.a.								
11	Demonstrimi dhe ndertimi i nje linjeve te reja 110 kV Uez - Dikupel - Shumiz	Bumel	Linje	110 kV	180,000,000	OST sh.a.								
12	Blerje dhe instalimi i dy AT: 220/110/10 kV me fuqi 60 MVA.	Bumel	Nendacion	220, 110, 10 kV	220,000,000	OST sh.a.								
13	Instalimi i qarkut te dyte te pranes kablore te linjes 110 kV Tirana2 - Gafte se bashku me nje dalje linje 110 kV.	Tirane	Linje	110 kV	220,000,000	OST sh.a.								
14	Financimi i mbyrjes rreze (software) PG&E, Mjerje e dy colave te rrezeve shpirtoreme i mjerjes	Tirane	Adm. Qendrore	-	10,000,000	OST sh.a.								
15	Rikonstrukcioni i godines se zyrave dhe sales se nenderteges, sistemit i shpirtore, si dhe ndertim mund te arrijet ndertimi i HEC dhe Nivocioni Vau Dejze	Shkoder	Nendacion	-	10,000,000	OST sh.a.								
16	Ndertimi Magazne ne Nel Rreshbull	Rreshbull	-	-	30,000,000	OST sh.a.								
17	Ndertimi magazne ne Nivocioni Elbasan 2	Elbasan	-	-	22,000,000	OST sh.a.								
18	Blerje programe (software) per projektim Linjash dhe Nivocioneve	Tirane	Adm. Qendrore	-	5,000,000	OST sh.a.								
19	Ndertimi i godines se zyrave Bumel	Bumel	-	-	25,000,000	OST sh.a.								
20	Rikonstrukcioni i ngjyrit te vajit	Tirane	NIMT	-	15,000,000	OST sh.a.								
21	Miksyty e pazurime per objektet e reja.	Tirane	Adm. Qendrore	-	10,000,000	OST sh.a.								
22	Instalimi i sistemit te kamerave per survejimin e tendat te Nivocioneve dhe ambjentet te brendshme, si dhe disa segmente te linjave 400-220 kV.		?		100,000,000	OST sh.a.								
23	Blerje dhe instalimi i analizatoreve te vajit dhe peracikimit te gjendjes se izolacionit per transformatore 400 kV	Tirane	NIMT	400 kV	140,000,000	OST sh.a.								
24	Blerje e nje softweri per planifikimin shqiptare dhe kalkulime te tjera financiare	Tirane	Adm. Qendrore	-	10,000,000	OST sh.a.								
25	Blerje Shift Ware per Operatoren e Tregut	Tirane	Adm. Qendrore	-	230,000,000	OST sh.a.								
26	Rikonstrukcioni i magaznave NIMT				3,000,000	OST sh.a.								
27	Blerje pajise serveri backup				3,700,000	OST sh.a.								
28	Projekti i varurit Nel 220/110 kV Koman - 1AP 220/110/10 kV 120 MVA, daljet perkatese: linja 110 kV Koman - Fusha amez				700,000,000	OST sh.a.								
Totali 2015					2,584,700,000									
Projektit me fondet e Huaja Vite 2015														
	Linja 400kV Tirane - Prishtine- Tirana 2-Kosovo B	Tirane, Prishtine	Linje	400 kV	34,839,890			KTW	6 vite	3.21%	30.06.2016-30.12.2024	16.04.2014	16.04.2016	
	Linja Ushtrave 110kV Shqiptet e Jugut	Enxelle, Prishtine	Linje	110 kV	39,062,830			KTW	6 vite	3.26%	30.12.2009-30.12.2024	27.03.2013	11.12.2015	
	Zgjerimi i sistemit te mbyrjes per konsumatorit e kualifikuar	Nendacionet e OSTEE	Mbështetje	20/10 kV	10,700,000			WB	7 vite	0.75%	31.10.2014-15.11.2038	Komk 2015	Komk 2017	
	L 220 kV Tirane - Rreshbull dhe fuqizimi i Nel Rreshbull	Gafte Tirane	Linja 220 kV dhe	220 kV	16,500,000			KTW	3.5 vjet		2015-31.12.2026	2015	2017	
	Fuqizimi i Rreze Ushtrave 110 kV te gjelbra te Tiranes dhe ndertimi i Nivocionit 400/110 kV Tirana 3	Gafte Tirane	he Nendacion	220/110 kV	24,000,000			KTW	3.5 vjet		2015-31.12.2027	2015	2017	

132,142,828

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006